

SHOQERIA TREGTARE
Me pergjegjesi të kufizuar

"FLB GROUP" shpk.
FIER

AKT THEMELIMI

Ne Fier , sot me daten 19/10/2021 ne te nenshkruarit :

1-Luca Lumberto, datelindja 23/09/1988, lindur dhe banues ne Galatina(LE) –Itali, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me karte identiteti me nr CA33358FP

2-Flavio Vegetti, datelindja 15/01/1961, lindur dhe banues ne Milano(MI) –Itali, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me pasaporte me nr YB7530560

3-Aleksander Gega, datelindja 11/07/1969, lindur dhe banues ne Fier, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me karte identiteti me nr id G90711020N

Me Vullnet të lire të plote , dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne baze te Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare” dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 me ndryshimet “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “ krijojme shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “ **FLB GROUP**” shpk Fier , Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku I sipercituar, me emrin “ **FLB GROUP**” shpk Fier, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise “ **FLB GROUP**” shpk eshte :

FIER, Lagjia Kastriot ,rruga Brigada XI sulmuese ,Pallati nr 9 ,kati i I-re

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen , seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.
Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqintmije) leke , formuar dhe nenshkruar nga ortaket , vlere e cila do te shlyhet mbasi shoqeria te jete rregjistruar ne QKR dhe i perket ortakeve te mesiperm ne perpjesetimin e meposhtem :

Z. Flavio Vegetti, zoterues i nje kuote me vlere 33000 (tridhjetee tre mije) lek,qe perben 33% te kapitalit themeltar

Z. Luca Luperto, zoterues i nje kuote me vlere 33000(tridhjetee tre mije) lek,qe perben 33% te kapitalit themeltar

Z. Aleksander Gega, zoterues i nje kuote me vlere 34000(tridhjetee kater mije)lek,qe perben 34% te kapitalit themeltar

Shoqeria pergjigjet per humbjet vetem me kapitalin e saj.



NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtar.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7



Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikës se Shqipërisë pjesërisht apo teresisht kontributet e tyre përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gje të tillë Asambleja e Ortakëve duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim. Shoqëria dhe të tretet duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 8

Objekti i veprimtarisë:

Shoqëria mund të kryejë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të gjitha operacionet në lidhje me blerjen e aksioneve në kuotat e shoqërive të tjera, në çdo formë, në çdo aktivitet, si dhe administrimin, menaxhimin, kontrollin dhe zhvillimin e këtyre aksioneve.

Shoqëria në veçanti mund të përdorë fondet e saj për krijimin, menaxhimin, zhvillimin dhe likuidimin e një portofoli të përbërë nga të gjitha letrat me vlerë dhe patentat e çdo origjine, të marrë pjesë në krijimin, zhvillimin dhe kontrollin e çdo shoqërie, të marrë me anë të kontributit, nënshkrimin ose opsionin e blerjes dhe në çfarëdo mënyrë tjetër, të gjithë titujt dhe patentat, ti realizojnë ato me shitje, transferim, shkëmbim ose në rast të kundërt, të promovojnë këto çështje dhe patente.

Shoqëria mund të marrë hua të çdo forme.

Shoqëria mundet, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, t'i japë çdo kompanie të grupit ose cilitdo aksioner asistencë, hua, paradhënie ose garanci. Në kuadër të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të japë kredi, hua me ose pa garanci ose të veprojë si dorëzanë për personat e tjerë fizikë dhe juridikë, në varësi të dispozitave të ligjit në lidhje me farefisninë

Për realizimin e aktiviteteve, kompania mund të përdorë format e financimit në financimin e projekteve. Nëse ndërhyrja profesionale është e nevojshme, kompania do të përdorë punën e Profesionistëve të regjistruar në regjistrat përkatës. Këta profesionistë mund të jenë partnerë ose të huaj për shoqërinë, me kusht që ata të përmbushin kërkesat e parashikuara nga ligji. Aty ku është e mundur duke iu referuar kompetencave të tyre përkatëse, në caktimin e detyrave, të preferuarit duhet të jene ortakët. Për të arritur qëllimin e objektit të shoqërisë, shoqëria do të jetë në gjendje të ushtroje aktivitetet e saj tregtare përmes përdorimit të shoqërive të saj dhe marrjes me qira të shoqërive të palëve të treta, krijimin e përfaqësive, përdorimin e ndërmjetësve dhe krijimin e degëve si në Evropë ashtu edhe në Azi dhe Afrika . Gjithashtu ajo mund të kryejë aktivitete të ngjashme dhe / ose plotësuese, të lidhura drejtpërdrejt dhe / ose tërthorazi me aktivitetin që përbën objektin e shoqërisë. Brenda kufijve të ligjit dhe instrumentalisht në arritjen e objektit të shoqërisë, shoqëria mund të: kryejë të gjitha operacionet e pasurive të luajtshme, të paluajtshme, transaksione tregtare, financiare dhe bankare që lidhen ngushtë me aktivitetet e planifikuara nga shoqëria; të japë ose marrë me qira dhe hua, impiante, pajisje, pasuri të paluajtshme dhe makineri, përfshirë automjetet motorike, si dhe kompani ose degë të kompanive; të marrë dhe menaxhojë interesat dhe aksionet në çfarëdo forme në shoqëri të tjera, konsorciume, kooperativa ose ndërmarrje që kanë çfarëdolloj objekti shoqërie, të fitojë dhe menaxhojë ristrukturimin e shoqërive me humbje ose në likuidim, të ketë pjesëmarrje në konsorciumet e kompanive; të veprojë si kontraktues i përgjithshëm; të kryejë aktivitete franchising në sektorë të ndryshëm.

Shoqëria herë pas here mund të japë miratime, garanci dhe dorëzani, si reale ashtu dhe personale, gjithashtu në favor të palëve të treta, duke specifikuar që këto operacione dhe aktivitete fundit (të rëndësishme për arritjen e objektit të shoqërisë) duhet të kryhen jo në rrugë parësore dhe jo në lidhje për publikun, domethënë pa karakterin e profesionalizmit.

Nëse është e nevojshme, shoqëria mund të përdorë ligjet lehtësuese të krediteve të sektorit, kombëtar, rajonal dhe të BE -së. Shoqëria gjithashtu mund të operojë përmes përdorimit të markave ose patentave të saj dhe / ose palëve të treta të regjistruara në përputhje me rregulloret aktuale. Aktivitetet që, në nder të tjerat e përmendura më sipër, i nënshtrohen autorizimit administrativ ose regjistrimit në regjistra, dhoma, regjistra publike, do të ushtrohen në mënyrë efektive pasi të keni marrë autorizimet dhe regjistrimet në fjalë nga shoqëria në fjalë, ose nga personat fizikë që veprojnë në emër dhe për llogari të saj ose të ngjashëm ose në çdo rast të lidhur me të në mënyrë direkte ose indirekte;



The image shows three handwritten signatures in blue ink, arranged horizontally from left to right. The first signature is highly stylized and appears to start with 'AG'. The second signature is also stylized and appears to start with 'J'. The third signature is more legible and appears to be 'Vegor Filor'.

NENI 9

Me vendim të Asamblese Ortakeve, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqerise.

NENI 10

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.

NENI 11

Asambleja e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Per Tregtarët dhe shoqerite tregtare " i njeh amblese se ortakeve .

Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 12

Administrator I shoqerise "FLB GROUP" shpk, është
1-Aleksander Gega, datelindja 11/07/1969, lindur dhe banues ne Fier, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me karte identiteti me nr id G90711020N

I cili është e zgjedhur ne kete pozicion per nje periudhe jo me shume se pese vjet .


NENI 13

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, te cilet nenshkruhen prej ortakut ne cdo faqe .


THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

"FLB GROUP" SHPK

Flavio Vegetti



Luca Luperto



Aleksander Gega

